



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

AKT I BRENDSHËM

MBI

PROCEDURAT E RINOVIMIT TË LICENCAVE TË OPERATORËVE PRIVATË AUDIO DHE AUDIOVIZIVË, TË LICENCUAR SIPAS LIGJIT NR. 8410, DATË 30.09.1998 "PËR RADION DHE TELEVISIONIN PUBLIK PRIVAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

A. Dispozita të Përgjithshme

1. Ky Akt i Brendshëm përcakton kriteret dhe procedurat për rinovimin e licencave të subjekteve audio dhe audiovizivë, të licencuar sipas ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të cilët e kanë paraqitur aplikimin për rinovimin e licencës pranë AMA-s, sipas kërkesave të ligjit të sipërcituar, apo që do të paraqesin aplikimin për rinovimin e licencës, pas hyrjes dhe në përputhje me ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".
2. Subjektet audio dhe/ose audiovizivë të cilëve u ka përfunduar afati i vlefshmërisë së licencës dhe nuk kanë depozituar aplikim për rinovimin e saj, njoftohen nga AMA për depozitim të aplikimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në paragrafin B të këtij akti, brenda 30 ditëve nga momenti i vënies dijeni.
3. Shqyrtimi i aplikimeve për rinovimin e licencave kryhet nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit, në përputhje me aktet normative në fuqi.
4. Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit (më poshtë Komisioni) përbëhet si më poshtë:
 1. Zëvendëskryetari i AMA-s ose një nëpunës i autorizuar nga Kryetari i AMA-s
Kryetar
 2. Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Licencave
Anëtar
 3. Drejtori i Drejtorisë Teknike
Anëtar
 4. Drejtori i Drejtorisë Ekonomike
Anëtar
 5. Drejtor i Drejtorisë së Programeve
Anëtar
 6. Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve
Anëtar
5. Në çdo mbledhje të Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe anëtarët e AMA-s, por pjesëmarrja e tyre nuk është e detyrueshme. Mbledhjet e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit drejtohen nga kryetari i Komisionit ose nëpunësi i AMA-s i autorizuar ndërsa procesverbalit mbahet nga sekretari i Këshillit të AMA-s.
6. Dokumentacioni i aplikimit për rinovim licence mund të dërgohet me postë, apo depozitohet dorazi në protokollin e AMA-s. Ai duhet të jetë i mbyllur në zarf, të jetë i vulosur, i firmosur dhe me mbishkrimin ku të saktësohet "*Aplikim për rinovim licence*". Në rastin e personave fizikë të cilët nuk kanë vulë, zarfi i aplikimit duhet të jetë detyrimisht i firmosur. Gjithashtu mbi zarfin e aplikimit pasqyrohet në mënyrë të qartë identiteti dhe adresa e saktë e aplikantit.
7. Dokumentacioni që përmban zarfi dhe që merret në institucionet shtetërore, duhet të jetë marrë jo më vonë se një muaj, nga data e dorëzimit të aplikimit.
8. Punonjësi i arshivë-protokollit në datën dhe orën e caktuar të mbledhjes së Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit i përcjell Komisionit, të gjithë aplikimet e depozituara për rinovim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

licence, të cilët duhet të jenë të pahapur.

9. Komisioni fillimisht bën verifikimin nëse dosjet e aplikimit janë të mbyllura, të firmosura e të vulosura dhe më pas procedohet me hapjen e secilit zarf dhe shqyrtimin e dokumentacionit që përmban zarfi i aplikimit. Pas hapjes së zarfit, çdo dokument numërohet nga sekretari i Komisionit, në prezencë të Komisionit.
10. Komisioni,verifikon nëse dokumentacioni i aplikimit, i paraqitur nga subjektet që kërkojnë të rilicencohen, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë Akt. Pas këtij verifikimi, dokumentacioni shqyrtohet në mënyrë të hollësishme nga anëtarët e Komisionit. Në rastet kur kërkohet shpejtësi, dokumentacioni mund të fotokopjohet, për t'u shqyrtuar paralelisht nga anëtarët e Komisionit.
11. Komisioni, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit, përgatit një relacion vlerësimi, i cili së bashku me procesverbalin e mbajtur nga sekretari, nënshkruhet nga të gjithë të pranishmit. Relacioni, së bashku me procesverbalin i përcillet Kryetarit të AMA-s për t'u përfshirë në materialet e mbledhjes së rradhës të AMA-s.
12. Dokumentacioni i depozituar nga subjektet i kthehet zyrës së protokollit, ndërsa relacionet e Komisionit i bashkëngjiten materialeve të mbledhjes së AMA-s dhe ruhen së bashku me to.
13. Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit si dhe anëtarët e AMA-s, që mund të jenë marrë me shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit, mbajnë përgjegjësi për saktësinë e përpunimit të të dhënave, si dhe për ruajtjen e konfidencialitetit të informacioneve me të cilat njihet në zbatim të këtij vendimi.

Informacionet në lidhje me shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve, nuk duhet t'u bëhen të njohura aplikuesve të tjerë apo personave të tjerë, që nuk janë të angazhuar zyrtarisht në këtë proces.

14. Për të gjitha mungesat e dokumentave apo parregullsitë e konstatuara në dokumentacion, vetëm në raste të veçanta dhe kur nuk dëmtohen interesat e personave të tretë, Kryetari i AMA-s, pas propozimit të Komisionit, mund të vendosë t'i caktojë një afat të ri aplikantit, për plotësimin e mangësive, apo parregullsive të konstatuara në dokumentacion.

B. Dispozita specifike për rinovimin e licencave

1. Gjatë shqyrtimit të aplikimeve të depozituara për rinovimin e licencave do të verifikohen kriteret e mëposhtme:
 - 1.1. Respektimi i kushteve të mëparshme të licencës, ku përfshihen:
 - realizimi i mbulimit të zonës së licencimit (sipas territorit dhe sipas popullsisë);
 - mbyllja e impianteve të instaluar jashtë zonës së licencimit;
 - respektimi i kushteve të licencës për sa i përket programeve, formati dhe struktura programore.
 - 1.2. Detyrimet financiare për periudhën që ka ushtruar veprimtari audio dhe audiovizive, ku përfshihen:
 - pagesa vjetore e licencës;
 - pagesa për tarifën e shërbimeve radiotelevizive;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- regjistrimi në organet tatimore;
- dorëzimi në KKRT/AMA i bilanceve vjetore me treguesit përkatës;
- pagimi i gjobave eventuale të vendosura nga KKRT/AMA
- numrin e llogarisë/ve bankare.

1.3 Dokumentacioni i aplikimit për rinovimin e licencës, duhet të përmbajë:

- a. Tabelën e Lëndës;
- b. Emërtimin e subjektit, vendndodhjen, formën ligjore të subjektit që bën kërkesën bashkë me emrin dhe firmën që ka të drejtë ta përfaqësojë atë;
- c. Ekstraktin Historik të Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit;
- ç. Dokumentet që vërtetojnë të dhënat zyrtare e bankare mbi kapitalin financiar, i cili duhet të jetë i vërtetuar me ekspert kontabël (likuiditete, asete të vërtetuara nga eksperti kontabël i autorizuar/ i miratuar), ose i pasqyruar në QKR, për periudhën e rinovimit të licencës;
- d. Parashikimi i planit ekonomik financiar, për shpenzimet dhe të ardhurat për periudhën e rinovimit të licencës, investimet që do të kryhen dhe burimet e financimit të tyre;
- dh. Emërtimin e programit dhe të rrjetit ku do të mbështetet, projektin teknik të instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave, zonën e mbulimit;
- e. Objektin dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit, përmbajtjen e programeve që do të transmetohen, strukturën programore, kohëzgjatjen e tyre, të cilat shprehin qartë pluralizmin në tërësinë e tyre dhe paanësinë e informacionit, ku përfshihen:
 - Programi javor i transmetimit.
 - Orë transmetimi në ditë, si dhe ora e fillimit dhe mbarimit të transmetimit.
 - Raporti i kohës së transmetimit që do të zënë emisionet e prodhuara vetë në lidhje me gjithë kohën e transmetimit;
 - Të dhëna statistikore për llojet e programeve që do transmetohen, si p.sh. informacion, kulturë-art, argëtim-zbavitje, ekranizime, programe për fëmije, sport, publicitet etj;
 - Grila e strukturës programore;
 - Përmbajtja e disa programeve kryesore që do të transmetohen.
- ë. Deklarata noteriale në zbatim të nenit 62 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Aplikantët për rinovimin e licencave për shërbim privat kabllor përjashtohen nga ky detyrim.
- f. Listen emërore dhe CV përkatëse të anëtarëve të Bordit Drejtues (të firmosura dhe që deklarojnë se janë dakord të jenë anëtarë të Bordit Drejtues);
- g. Kontratat e punës dhe pagesa e detyrimeve të sigurimeve shoqërore për punonjësit e siguruar, për të gjithë periudhën e mëparshme të licencës;
- gj. Dokumentacioni që vërteton të drejtën e transmetimit të programeve (marrëveshje, kontratë shitjeje, shkëmbimi ose dhurimi) dokumentacion, i cili duhet të jetë i regjistruar dhe certifikuar paraprakisht në ZSHDA;
- h. Deklarata mbi vërtetësinë e të dhënave të paraqitura;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

2. Aplikanti duhet t'i përgjigjet çdo pyetjeje dhe kërkesë të AMA-s gjatë shqyrtimit të aplikimit.
3. Në rastin e aplikimeve për rinovimin e licencave për subjektet televizivë privatë kabllorë, të cilët e kanë paraqitur aplikimin për rinovimin e licencës sipas ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, aplikantët duhet t'i përgjigjen çdo kërkesë shtesë të AMA-s, në zbatim të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

Këto subjekte duhet të jenë regjistruar paraprakisht në AKEP, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" dhe të depozitojnë pranë AMA-s, Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit lëshuar nga AKEP AKEP. Kur vlerësimi dhe shqyrtimi tërësor i aplikimeve për këto subjekte, rezulton pozitiv, AMA, vendos rinovimin e autorizimit për ripërsëritjen e shërbimit të programeve audio dhe/ose audiovizive mbështetur në rrjet kabllor për një afat 5 vjeçar.

4. Në rastin e aplikimeve për rinovimin e licencave për subjektet televizivë privatë analogë vendorë, të cilët e kanë paraqitur aplikimin për rinovimin e licencës sipas ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, aplikantët duhet t'i përgjigjen çdo kërkesë shtesë të AMA-s, në zbatim të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

Kur vlerësimi dhe shqyrtimi tërësor i aplikimeve për këto subjekte, rezulton pozitiv, AMA, del me vendim për zëvendësimin e licencave të subjekteve televizivë me licencë për transmetime si më poshtë:

- a) licencë të shërbimit të programit audioviziv, e cila do të jetë me afat 8 vjeçar sipas kërkesave të ligjit nr. 97/2013;
 - b) licencë për vijimin e ushtrimit të veprimtarisë në rrjetin analog me afat deri në datën 17.06.2015, data e mbylljes së transmetimeve analoge.
5. Në rastin e aplikimeve për rinovimin e licencave për subjektet radiofonikë privatë analogë vendorë, të cilët e kanë paraqitur aplikimin për rinovimin e licencës sipas ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, aplikantët duhet t'i përgjigjen çdo kërkesë shtesë të AMA-s, në zbatim të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

Kur vlerësimi dhe shqyrtimi tërësor i aplikimeve për këto subjekte rezulton pozitiv, AMA del me vendim për rinovimin e licencës për transmetim audio, me afat 3 vjeçar në fushën e transmetimeve audio analoge.

- Ky Akt i Brendshëm hyn në fuqi pas miratimit nga AMA.